



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSO

VEPNDORËSHTË I PLOTFUQISHËM
QDËLKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Numri i lëndës: 2018:013792

Datë: 14.06.2018

Numri i dokumentit: 00062750

Më
Data

12.11.2018

P.nr.1013/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi dhe zyrtare ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Prishtina, për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr.1484-5/16 të dt. 26.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit [REDACTED], si dhe të akuzuarit [REDACTED], me dt. 07 Maj 2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 15 Maj 2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më datën [REDACTED] në Fsh. [REDACTED] me vendbanim në rrugën [REDACTED] pn. Prishtinë, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, i martuar, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së.

LIROHET NGA AKUZA

Se me dt. 22.07.2016, rreth orës 00:30, në Fshatin Komogllavë K. Ferizaj, saktësisht në rrugën e KFOR-it, i pandehuri si roje fizike gjatë kujdesit për pasurinë e të dëmtuarit Kompanisë “Bechtel Enka” i ka keqpërdor autorizimet autorizimet e tij, me qëllim që me përvetësimin të sendeve të huaja e të luajtshme, vetit ti sjellë përfitim pasurorë të kundërligjshëm, në atë mënyrë që ka vjedhur derivate të naftës nga gjeneratorët e kompanisë, duke dëmtuar me humbje të derivateve dhe pajisje të punës në vlerë 4100 euro /katërmijë e njëqind/, i njëjti i kishte vendosur katër /4/ bidona me naftë në veturën e tij “VW Jeta”, ngjyrë e kuqe dhe një bidon është gjetur rrethe 50 metra larg veturës dhe gjatë një kontrolli nga policia i kanë gjetur bidonat me naftë.

meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par. 1 të KPRK-së.

- E dëmtuara, përfaqësuesi juridik i Kompanisë Bechtel Enka me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me aktakuzën e evidentuar PP/II. nr. 1484-7/16 të dt. 26.04.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Prishtina, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 07.05.2018, në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës – Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit

juridik të veprës penale duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtores dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

Mbrojtja e të akuzuarës

I akuzuari [REDAKTUAR] në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij ka mohuar faktin se ka vjedhur derivatet dhe sendet në kompaninë [REDAKTUAR], përndryshe ka punuar roje (sigurim) në këtë kompani për rreth tre muaj, kur kishte ndodh vjedhja në kontinier ky kishte qenë në shtëpi e jo në orare të punës, ndërsa kur është vjedhur sasia e naftës fare nuk ka njohuri, fakti se edhe më herët është vjedhur naftë policia kanë kontrolluar terrenin dhe në ndër kohë në veturën time janë gjetur 4 /katër/ bidona të zbrazura, deri sa në terren ka gjetur edhe një bidon jo timin.

I akuzuari deklaron se atë natë ka pasur në planë të marrë naftë mirëpo bindje të plotë dhe përgjegjësi pohon se nuk ka marrë naftë, këtë e dëshmojnë edhe bidonët e zbrazura, më herët ka marrë naftë për ta mbushur veturën e tij por jo edhe për datën që e ngarkon akuza, aty ka shumë persona që vjedhin naftë. Detyra e tij si roje ishte të ruaj një vinçë, tre gjenerator, tetë kontinjera si dhe disa skele, ditën kritike ka marrë punën në ora 18:45 për të punuar deri të nesërmen në ora 07:00 të mëngjesit ditën vijuese, ditën kritike nuk e ka pranuar punën nga askush thjeshtë është paraqitur në punë dhe ka filluar rojën, nuk mbajnë shënime, në fund të orarit sapo të vijnë punëtorët e Bechtellit këta largohen nga vendi, për vjedhjen në kontinjer është njoftuar nga përgjegjësi [REDAKTUAR], këta nuk kanë qasje në kontinjera as nuk i mbyllin as nuk i hapin, siç i lenë turqit ashtu mbesin.

Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor

Pasi që të akuzuarit nuk kanë pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor;

- përmes leximit të vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të përkohshme në emër të [REDAKTUAR];
- përmes dëgjimit të dëshmitarit [REDAKTUAR], mbikëqyrës i sigurisë në Bechtel Enka;
- përmes shikimit në fotografitë e vendit të ngjarjes.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- se në Kompanin Bechtel Enka, saktësisht në pikën e fshatit Komogllavë K. Ferizaj, i janë vjedhur derivatet, sasia nuk është e përcaktuar;
- ishin vjedhur edhe disa pajisje pune, pa e përcaktuar llojin e pajisjeve apo veglave të punës, vlera e dëmit sipas të dëmtuarve është 4100 euro.

Andaj në këtë çështje penale ka qenë kontestuese vërtetimi i fakteve për implikimin e të akuzuarit përkatësisht vërtetimi i faktit se a ishte i akuzuara kryerëse i veprës penale të keqpërdorimit të besimit.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR] – mbikëqyrës i sigurimit, vërtetohet se për rrethe nëntë vite punon në këtë kompani, dhe se në lidhmë me këtë rast penal ka dhënë një deklaratë në polici për ç'ka e ka nënshkruar edhe qëndron pas saj, e gjithë makineria në projektin e rrugës 6 deri në Hanë të Elezit, është nën mbikëqyrjen e sigurisë tina, në vendin konkret në fshatin Komogllavë është e vërtet se kanë pasur makineri si bagera, gjenerator, kontinjer ndërsa roje në këtë pik ka qenë [REDAKTUAR]

Në pikën e fshatit Komogllavë është e vërtet se ka pasur humbje të derivateve, ky personalisht nuk e ka parë askënd tu vjedhë naftë e as ndonjë person që ka vjedhur gjëra nga kontinjeri, kjo ishte edhe arsyeja që kanë lajmëruar rastin në polici për të hetuar se kush e ka bërë. Ky personalisht nuk i ka parë kanisterat apo bidonat që i janë zënë të akuzuarit mirëpo mesa ky e dinë ato janë kanë të zbrazura, në një pik (punishte) kanë bërë roje 2-3 persona, deri sa dëmi që është shkaktuar e kanë kompensuar nga kompania Alfa Siguri, ndërsa sa i përket rastit të sendeve të vjedhura që përmendet në akuzë njofton gjyqtarin se pikërisht për këto

sende janë të dyshuar disa persona nga Fsh. Mamush të Kompanis "Lider Grup". Megjithatë përmes kësaj dëshmie vërtetohet vetëm aspekti objektiv i kësaj vepre penale se sendet ishin marrë nga punishtja e bechtel enkes por pa arritur që të specifikoj se kush ishte kryerëse e kësaj vepre penale çoftë të vjedhjes çoftë mënyrën e shpërdorimit nga ana e të akuzuarut.

Andaj nga dëshmia e tij vetëm vërtetohet se kompanisë i është vjedhur derivate dhe pajisje të punës në punishten e fshatit Komogllavë, megjithatë nga kjo dëshmi nuk është përcaktuar edhe sasia e derivateve të vjedhura, sendet për punë nuk janë të konkretizuara dhe individualizuara se për qar sende bëhet e ditur vetëm se thuhet "pajisje", nga dëshmia e tëtij dëshmitari nuk vërtetohet koha, ndërsa për datën e supozuar të kryerjes së veprës penale është nënkuptuar vetëm at'her kur gjatë kontrollit rutinor nga policia janë gjetur bidonët e zbrazura, dëshmia ishte e saktë për faktet e pohuara dhe nuk u gjet ndonjë rrethanë që do ta dëmtonte besueshmërinë e saj për më tepër kjo dëshmi është në përputhje edhe me provat materiale (vërtetimin për konfiskimin e përkohshëm të sendeve në emër të [REDACTED]).

Kurse përmes provave materiale (vërtetimin për konfiskimin e përkohshëm të sendeve në emër të [REDACTED]), Gjykata vlerëson se janë prova të besueshme por që nuk vërtetojnë aspektin objektiv të kësaj vepre penale e as se sendet janë vjedhur, fakt ky jokontestues edhe nda dëshmia e dëshmitarit [REDACTED], ndërsa po ti referohemi dispozitivit të aktakuzës rreshti i fundit ".....gjatë kontrollit nga policia i kanë gjetur këta bidona me naftë" është në kundërshtim me vërtetimin për konfiskim të sendeve sepse aty përcakton se konfiskohen katër /4/ bidona, sasia 30 litra të zbrazura, ngjyrë e kaltër dhe një /1/ sasi 12 litra e zbrazur, ngjyrë e kafet, te vendi ku punon i dyshuari, andaj dispozitivi akuzës jepe të kuptohet se janë të mbushur me naftë deri sa gjendja faktike me provat e propozuara nga organi akuzës dëshmon gjendjen faktike të kundërt, bazuar në këtë nuk e vërteton aspektin subjektiv të shpërdorimi apo keqpërdorimit të besimit.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit [REDACTED] në të gjitha fazat e procedurës penale është përqendruar në kundërshtimin e fakteve se kishte kryer këtë vepër penale të peshkuar në akuzë por pa paraqitur hollësi dhe detaje për këtë çështje.

Por gjykata tezës së të akuzuarit i besoi për faktet vendimtare të kësaj çështje përkatësisht nuk qëndron keqpërdorimi i besimit në atë mënyrë që vetes ti mundësojë vjedhjen meqë kjo mbrojtje është në përputhje të plotë me provat e tjera. Më të besueshëm e bënë faktin se i

akuzuari në natën kritike kur është ndaluar ka pranuar edhe para organeve të hetuesisë si dhe par gjykatës se kishte në plan të mbush naftë por në asnjë mënyrë ta ketë marrë naftën dhe pajisjet që i ngarkon me aktakuzë prokurori i shtetit.

Vlerësimi i aspektit ligjor

Gjykata në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 262 par. 1 të KPP-së, “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”.

Andaj bazuar në dispozitën e lartëcekur konstatoi se në këtë çështje penale kemi vetëm një dëshmi (dëshminë e dëshmitarit [REDACTED]) ndërsa provat e tjera materiale (vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve) vërtetojnë vetëm aspektin objektiv se i janë sekuestruar përkohësisht bidonët e zbrazur gjë që nuk e konteston as vetë i akuzuari por nuk vërtetojnë se i akuzuara ka qenë kryerëse e kësaj vepre penale.

Nga ekzaminimi i të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor, nuk vërtetohet se cilat veprime të kontraktuara i akuzuari nuk i ka ndërmarr për të cilat ka qenë i detyruar ti ndërmerr, qar keqpërdorimi të autorizimeve ka ndërmarr në lidhje me përfaqësimin e interesave pasurorë apo përkujdesjen e pasurisë, qëllimin e përfitimit për vete apo për tjetrin.

Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke propozuar që e akuzuara të shpallet fajtores dhe të i shqiptohet dënim sipas ligjit, duke përshkruar provat materiale.

Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryerëse e kësaj vepre penale, por, shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të bazuar mirë.

Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet në “adutin kryesor” (dëshminë e dëshmitares [REDACTED]) dhe provat material vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, të cilat do ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari veprimin e të akuzuarit e përshkruan në mënyrë abstrakte dhe në vijë tejet të përgjithësuar pa elaboruar hollësi dhe detaje, për më tepër e gjithë këtë veprim të tij e përshkruan se i akuzuari *"ka vjedhur derivate të naftës nga gjeneratorët e kompanisë, duke dëmtuar me humbje të derivateve dhe pajisje të punës në vlerë 4100 euro /katërmijë e njëqind/, i njëjti i kishte vendosur katër /4/ bidona me naftë në veturën e tij "VW Jeta", ngjyrë e kuqe dhe një bidon është gjetur rrethe 50 metra larg veturës dhe gjatë një kontrolli nga policia i kanë gjetur bidonat me naftë"*², e që në fakt për Gjykatën është i paqartë se nga vjen ky konkludim i Prokurorit të Shtetit edhe pse bidonat janë marrë në veturën e të akuzuarit të zbrazura dhe pajisjet për të cilat pretendohet në aktakuzë nga dëshmitari u konfirmuan se janë të dyshuar sida persona nga Fsh. Mamush të Kompanis "Lider Grup", por ka mbetur e pasqaruar se kush ishin këta persona që i kanë marrë sendet nga aty, pra nuk u vërtetua se këtë e kishte bërë i akuzuaria;

- më tutje Prokurori i Shtetit vazhdon me paraqitjen e fjalës përfundimtare se *"...se atë natë ka qenë në detyrë dhe ka pasur për obligim të ruaj dhe siguroj mjetet dhe pajisjet të cilat gjendeshin aty se kryerja e kësaj vepre penale vërtetohet pjesërisht edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit etj. se i janë gjetur bidonët në veturë..."*³ që edhe Gjykata pajtohet plotësisht me këtë konstatim se është fakt i pakontestueshëm se i janë gjetur 5 bidona (të zbrazur) por ky paraqet vetëm aspektin objektiv edhe atë jo të plotë të kësaj ngjarje dhe jo edhe aspektin subjektiv - personin që ka kryer veprën penale kur dihet se në piken e fshatit Komogllavë, rojet të sigurisë ishin 2-3 persona, e vërtetuar nga dëshmitari [REDACTED] - shef i sigurimit, pyetja lind se potencialisht a kanë mundur edhe këta persona të jenë të implikuar në këtë ngjarje apo ti kanë mundësuar dikujt të marrin pajisjet, megjithatë për gjykatën nuk janë subjekt këta dhe mbetet e pa vërtetuar dhe për të akuzuarin.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në

² Fjala përfundimtare e Prokurorit të Shtetit

³ Po aty

ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë "*in peius*" ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë "*in favorem*" ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Kërkesa pasurore – juridike dhe shpenzimet procedurale

Në kuptim të nenit 463 par. 3 të KPP-së, e dëmtuara Kompania Bechtel Enka, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM


P.nr.1013/17 datë 15.05.2018.

Zyrtare ligjore,

Kadishe Shabani

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.